



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1009/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Graast” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810505844 me seli në Peroc, Graçanicë, kundër debitorit “The North Unicorn” L.L.C., me numër unik identifikues 810112186 me seli në Prishtinë, Zona Industriale, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë A.K. dhe G.V., avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 213/23, i lejuar me datë 05.05.2023, nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 22.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “The North Unicorn” L.L.C., me numër unik identifikues 810112186 me seli në Prishtinë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 213/23, i lejuar me datë 05.05.2023, nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 213/23, i lejuar me datë 05.05.2023, nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, **MBETET NË FUQI.**

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 5498/22 e datës 05.10.2022; Faturës nr. 6124/22 e datës 03.11.2022; Faturës nr. 6889/22 e datës 13.12.2022; Faturës nr. 6440/21 e datës 03.12.2021, si dhe; Faturës nr. 5252/21 e datës 06.10.2021, ka lejuar Urdhrit Përmbarimor P.nr. 213/23, të datës 05.05.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që në emër të faturave kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 12,114.89, me kamatëvonesë prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se faturat me të cilat është iniciuar procedura përmbarimor janë të panënshkruara dhe të pavulosura nga ana e debitorit, ashtu që të njëjtat nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të përshtatshme për përmbarim në kuptim të nenit 29.3 të LPP-së. Më tej, ka shtuar se për faturat e pranuar dhe nënshkruara ka bërë pagesë në vlerë të përgjithshme prej EUR 3,200.95, që dëshmohet nga transaksionet bankare datë 25.11.2022, 07.12.2022 dhe 27.01.2023. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, urdhri përmbarimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuara, ndërsa ka shtuar se urdhri përmbarimor është i bazuar, i ligjshëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore, përkatësisht në nenin 21, 22.1, pika 1.1 dhe neni 38 të LPP-së. Tutje, ka theksuar se qëllimi i vetëm i debitorit është shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën dëshmon se nuk ka borxh ndaj kreditorit. Po ashtu faturat janë në origjinal, të nënshkruara dhe të vulosura nga kreditori dhe debitori. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ashtu që urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumente të besueshme, përkatësisht faturat e përshkruara si në hyrje të arsyetimit të këtij aktvendimi, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29,

paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është furnizuar debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Tutje, gjykata gjen se faturat mbi të cilat mbështet propozimi për përbarim janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit, ndërsa të njëjtat janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga ana e debitorit, ndërsa, për të njëjtat fatura kreditori ka lëshuar edhe dëshmi mbi pranimin e mallrave objekt të faturave, çka nënkupton se debitori ka qenë i njoftuar me faturat në fjalë si për nga përmbajtja e tyre ashtu edhe për nga lartësia.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përbarimor, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe e nënshkruara nga debitori.

Gjykata ka vlerësuar edhe urdhërpagesat e bankës të datave 25.11.2022 në vlerë prej EUR 1,116.45, dhe atë të datës 27.01.2023 në vlerë prej EUR 1,000.00, e të cilat debitori i ka bashkangjitur në prapsim, mirëpo, nisur edhe nga vet deklaratimet e debitorit në prapësim rezultojnë se këto pagesat janë bërë për detyrime tjera dhe nuk janë pagesa të kryera në emër të faturave për të cilat kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore në kuptim të nenit 71 të LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1009/23, datë 19.01.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.